



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1130/1 Prot.
2023

Tiranë, më 02 . 11 .

V E N D I M

Nr. 223 , datë 02 . 11 . 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 221 Regj., datë 18.10.2023, të shtetasit K. Ç, kundër Policisë Bashkiake Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “vendbanimit” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, shtetasi K. Ç, në shpjegimet e paraqitura para Komisionerit, është shprehur se, problematika e tij konsiston si më poshtë citohet:

“Jemi pronarë të ligjshëm të një sipërfaqeje trualli, por nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë, nuk na lejohet të parkojmë automjetet tona në këtë truall, me pretendimin se pengojmë hyrje-daljen e një shtetasi tjetër, me mjetin e tij në garazhin që ai pretendon se e ka blerë me dokumente të rregullta. (Komshi me ankuesin).

Policia Bashkiake për të na bërë presion vendos gjoba për mjetet tona, ndërkohë që ato gjenden të parkuara në truallin që është pronë e jona”.

Në vijim të shpjegimeve të situatës faktike të tij, ankuesi deklaron se:

“Sipas lejes së ndërtimit me nr. 426, datë 30.06.1998, të Bashkisë së Tiranës, shoqëria “Besa” sh.p.k, ka ndërtuar në rrugën “Budi”, sot rruga “Xhavid Shyqyri Demneri”, në pronën e familjes B, një objekt 8 kate, plus një kat nëntokë.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

Me kontratë noteriale bashkëshortja e ankuesit E. Ç, së bashku me shtetasit Th. V dhe V. J kanë blerë nga kjo Shoqëri, në këtë objekt, dyqan, garazh dhe një sipërfaqe truall të lirë, të cilën kjo Shoqëri e ka përfutuar me kontratë shkëmbimi nga pronarët e truallit mbi të cilin ajo ka ndërtuar objektin.

Bazuar në këtë kontratë Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Tiranë i ka regjistruar këto prona me nr. 20 hipotekor, datë 08.02.2001, me nr. 4/293 të pasurisë, Zona Kadastrale 8160, Tiranë.

Më pas, me kontratë pjesëtimi, E. Ç, Th. V dhe V. J kanë ndarë pasuritë dyqan, bodrum, ndërsa truallin vazhdojnë ta kenë në bashkëpronësi edhe sot e kësaj dite, të tre bashkarisht. Në vitin 2001, kur unë dhe familja ime jemi vendosur me banim në këtë pallat, jemi përballur me presione të bëra nga shtetasit A. P dhe K. K, të cilët banonin në pallatin pranë nesh, pallat i ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave Tiranë.

Këta dy shtetas, duke pretenduar se ishin pronarë legjitimë të garazheve që ndodheshin disa metra larg pallatit ku banonin, por mbi truallin pronë e jona, na kërkonin me këmbëngulje që të kalonin me mjetet e tyre në pasazhin e pallatit që është edhe soleta e garazhit, pjesë e pronës së familjes time, por edhe në truallin të cilin ne e kishim blerë pikërisht për të parkuar makinat tona.

Të përballur me presione dhe konflikte të vazhdueshme me këta shtetas, ne iu drejtuar Policisë së Ndërtimit, Dega Tiranë duke iu kërkuar prishjen e garazheve, sepse ishin ndërtime pa leje, të ndërtuara mbi pronën tonë, duke na krijuar edhe konflikte të vazhdueshme.

Policia e Ndërtimit, Dega Tiranë, me shkresën me nr. 2869/1 prot., datë 05.12.2001, në kthim përgjigjen e saj, na bën me dije se, ZVRPP Tiranë, me shkresën me nr. 1000 prot., datë 14.11.2001, ka konfirmuar se garazhet janë të regjistruara në emër të dy shtetasve A. P dhe K. K, me të cilët ne kishim konfliktin në fjalë; dhe se, pronësinë e tyre ata e kanë fitur nga Enti Kombëtar i Banesave Tiranë.

Për të vërtetuar se si qëndronte e vërteta në lidhje me pronësinë e garazheve në fjalë, ne iu drejtuar këtij Enti shkresërisht.

Në vijim të kërkesës tonë për informacion, Enti Kombëtar i Banesave (EKB) Tiranë, me shkresën me nr. 119 prot., datë 21.03.2002 na sqaron se, nuk ky Ent nuk ka ndërtuar e hipotekuar garazhe, dhe bashkëlidhur na ka vënë në dispozicion kontratën e shitjes me nr. 2898 rep., 903 kol., datë 07.12.1999, të lidhur midis EKB Tiranë dhe shtetasve A. P dhe Y. P, si dhe kontratën e shitjes me kusht me nr. 1744 rep., 388 kol., datë 11.07.2000, të lidhur midis EKB Tiranë dhe shtetasve K.K, K. K, S. K, dhe Zh. K.

Referuar kontratës së shitjes me nr. 2898 rep., 903 kol., datë 07.12.1999 rezulton se objekt i kësaj kontrate ka qenë vetëm shitja e një apartamenti.

Ndërsa referuar kontratës së shitjes me kusht me nr. 1744 rep., 388 kol., datë 11.07.2000, noteri në kundërshtim flagrant me ligjin, e regjistron këtë garazh së bashku e apartamentin në një numër hipotekor me kontratën me nr. 2625 rep., 659 kol., datë 16.08.2001.

Me këtë kontratë, Y. P i shet të birit pjesën e vet të apartamentit, dhe noteria M. Ll, në kundërshtim me ligjin shton se objekt i kontratës është edhe një garazh me sipërfaqe 23 m²

dhe ZVRPP Tiranë, në kundërshtim me ligjin e regjistrion edhe garazhin së bashku me apartamentin në një numër hipotekor dhe numër pasurie, ndërkohë që garazhi ndodhej disa metra larg pallatit të ndërtuar nga EKB Tiranë dhe mbi pronën tonë truall.

Pasi vërtetuam mënyrën se si është vepruar për regjistrimin e garazheve, ndërtim pa leje, unë kam depozituar në Prokurorinë e Rrethit Tiranë kallëzim penal kundër shtetasve A. P dhe K. K, të cilët i kam akuzuar për veprën penale të fallsifikimit të dokumentacionit.

Prokuroria ka regjistruar procedimin penal me nr. 829, të vitit 2008, dhe si përfundim ka vendosur pushimin e çështjes me arsyetimin se vepra penale ishte parashkruar, ndërkohë që kallzimi penal është paraqitur pa u mbushur afati i parashkrimit.

Në kushtet kur konflikti po vazhdonte, në fund të vitit 2018, i jemi drejtuar Gjyaktës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me një padi kundër shtetasve K. K, A. P, si dhe kundër Bashkisë Tiranë, ZVRPP Tiranë, EKB Tiranë, me objekt të padisë lirim dhe dorëzimin e truallit dhe pavlefshmërinë e pjeshme të kontratave me nr. 2625 rep., 659 kol., datë 16.07.2001 dhe me nr. 1744 rep., 338 kol., datë 10.07.2000, përse i përket garazheve. Procesi gjyqësor vazhdon ende.

Në fund të vitit 2020, shtetasi A. P ka i shitur shtetasit Dh. S, apartamentin që ndodhet në katin përdhe, si dhe garazhin objekt gjykimi në Gjykatë. Blerësi i ri, pasi është pajisur me certifikatë pronësie ka filluar punimet brenda apartamentit, si dhe jashtë tij duke kryer punime në shtesën pa leje që më parë kishte shtetasi A. P, por ndërkohë kryen punime edhe në garazhin e blerë, si dhe atë të ndërtuar nga shtetasi K. K.

Përballë faktit që ky shtetas (blerësi i ri) po kryente punime pa leje jashtë apartamentit si dhe në garazhet ndërtim pa leje, gjithashtu po rrethonte edhe pjesë nga territori pronë publike, duke e kthyer në pronë private, ndërkohë që procesi gjyqësor në të cilin kemi kërkuar lirim dhe territorit pronë e jona private, vazhdon ende. Lidhur me uzurpimin e pronës publike kam paraqitur kallzim penal kundër tij, duke e akuzuar për veprën penale të ndërtimit pa leje si në pronën tonë private, ashtu dhe atë publike.

Me vendimin nr. 926, datë 06.10.2022, të Gjykatës së Apelit Tiranë, është urdhëruar Prokuroria që të vazhdojë hetimet, ndërkohë që ky shtetas është thirrur si i paditur.

Në muajin janar të vitit 2023, edhe shtetasit K. K dhe K. K e kanë shitur apartamentin dhe garazhin, fakt të cilin e kemi mësuar në datën 22.09.2023, kur u paraqit shtetasi A. S (blerësi i ri) i cili na kërkoi që të mos parkonim makinat në trullin pronë e jona, sepse e donte rrugën të lirë për të parkuar makinën e tij në garazhin që ai kishte blerë së bashku me banesën.

I kërkuam këtij shtetasi që të paraqiste certifikatën e pronësisë për garazhin, si dhe kontratën e shit-blerjes, por ai jo vetëm që nuk i paraqiti, por vazhdon angazhon forcat policore: Policinë e Rendit si dhe Policinë Bashkiake. Kjo e fundit ka vendosur gjoba për makinat tona të parkuara në truallin pronë e jona, të cilin kemi rreth 23 vite që e përdorim edhe si parkim.

...kuptohet qartë se në këtë skenar presioni kanë bashkëpunuar ngushtësisht shtetasit A. S, K. K dhe A. Ç, të cilët duke shfrytëzuar lidhjet familjare e miqësore, shoqërore, si dhe duke përdorur edhe korrupsionin, fillimisht kanë vënë në lëvizje Policinë e Rendit e më pas atë Bashkiake, ku kjo e fundit në kundërshtim me ligjin, vjen e vendos gjoba për mjetet tona të cilat gjenden të parkuara në truallin pronë e jona duke shpërdoruar detyrën. Nga Policia Bashkiake na bëhet presion i vazhdueshëm që të largojmë mjetet nga vendi ku i kemi parkuar, në truallin pronë e jona, orar e pa orar deri në orët e vona, në sy të të gjithë banorëve të pallatit, duke na terrorizuar e diskriminuar në mënyrën më të paimagjinueshme sikur ne të ishim kriminelë, ndërkohë që ne jemi në pronën tonë, të cilën e kemi blerë me dokumenta të rregullta ligjore.”

Subjekti ankues ka depozituar në cilësi prove, kopje të gjobave të datave respektive: 26.09.2023, 28.09.2023, 29.09.2023, 30.09.2023, 01.10.2023, 03.10.2023 dhe 05.10.2023, të Policisë Bashkiake Tiranë.

Subjekti ankues me datë 29.09.2023 i është drejtuar me një ankesë Policisë Bashkiake Tiranë, lidhur me situatën e krijuar, duke kundërshtuar gjobat e vëna, si dhe duke i bashkëlidhur kopje të dokumentacionit me anën e të cilit donte të dëshmonte pronësinë e truallit ku ai kishte parkuar automjetet e tij.

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të tij nga Policia Bashkiake Tiranë, si dhe marrjen e masave që të parandalohen veprimet diskriminuese kundrejt tij.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Nga këqyrja e analizimi i dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, si dhe referuar deklaratimeve të subjektit ankues, rezultoi se:

Subjekti ankues banon në pallatin nr. 34/1, tek rruga “Xhavit Shyqyri Demneri”, Tiranë, pallat i ndërtuar në vitin 2000, dhe para se të ndërtohej pallati, në oborrin e tij kanë qenë të ndërtuara dy garazhe, të shtetasve K. K dhe A. P, banorë të pallatit ngjitur me atë të ankuesit.

Shtetasi A. P ka shitur më pas apartamentin e tij në katin e parë, të cilin e ka blerë shtetasi Dh. S, i cili, ka kryer punime brenda dhe jashtë tij, e po ashtu, edhe në garazhin, për të cilin pretendohet se është në pronësi të A. P. Punimet kanë nisur në një distancë kohore rreth një muaj nga njëri-tjetri.

Në kallzimin e depozituar në Prokurori, ankuesi ka ngritur pretendime në lidhje me parregullsinë e mënyrës së fitimit të pronësisë të dy garazheve (të shtetasve K. K dhe A. P), në emër të dy pronarëve të cilët pretendonin pronësinë e tyre.

Ankuesi ka pretenduar në kallzimin e tij se, veprimet juridike për kalimin e pronësisë së këtyre dy garazheve janë kryer në bashkëpunim nëpërmjet mashtrimit dhe falsifikimit të dokumentacionit, nga shtetasit e kallzuar, në bashkëpunim me nëpunës të EKB Tiranë. Po ashtu ai ka pretenduar se punimet nga këta shtetas (përfshirë edhe garazhin) janë kryer pa lejen e organeve kompetente.

Ankuesi ka pretenduar në kallëzimin e tij se, këto dy garazhe janë të ndërtuara pjesërisht mbi pronën e tij private dhe një pjesë në pronën publike, duke cenuar oborrin e pallatit dhe pronën publike.

Pretendimet e tij, lidhur me pronësinë e truallit në të cilin janë ndërtuar garazhet, si dhe lidhur me faktin se janë ndërtuar pa lejen organeve kompetente, duke konsumuar elementë të veprave penale, ankuesi i ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor, ndodhur në kushtet e një konflikti të mirëfilltë civil të ankuesit dhe dy banorëve të pallatit ngjitur me pallatin e tij.

Pretendimet sa më sipër, ankuesi i ka bërë pjesë të kallzimit të tij penal me nr.1411, të vitit 2021, kallzim mbi të cilin, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 15.02.2021, ka vendosur mosfillimin e procedimit të kallzimit penal.

Nëpërmjet kërkesës penale me nr. 847 akti, datë 06.04.2021, ankuesi ka kundërshtuar vendimin e Prokurorisë, me objekt: “Kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Për mosfillimin e procedimit penal me nr. 1411, të vitit 2021””.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi shqyrtoi ankimimin e kallëzuesit, me vendimin nr. 847 regj., datë 22.06.2021, ka vendosur:

“Rrëzimin e ankimit të kërkesit K. Ç, për shfuqizimin e vendimit, datë 15.02.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si të pabazuar në ligj e prova”.

Kundër këtij vendimi, ka ushtruar të drejtën e ankimimit kallëzuesi K. Ç, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës sipërcituar, shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 15.02.2021, në lidhje me kallzimin penal nr. 1411/2021, si dhe regjistrimin e procedimit penal e vijimin e hetimeve për sa ka parashtruar.

Lidhur me këto pretendime të ankuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 926, datë 06.10.2022, ka disponuar, ndër të tjera:

“...Shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Për mosfillimin e procedimit penal”, që i përket kallzimit penal nr. 1411, të vitit 2021.

Urdhërimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e procedimit penal dhe vazhdimin e hetimeve për kryerjen e aktit të ekspertimit teknik.”

Ankuesi pretendon për veprime arbitrare, disfavorizuese nga ana e Policisë Bashkiake, pasi ajo i ka vënë gjoba të njëpanjëshme, për automjetet e tij të cilat ai i ka parkuar në pronën e tij private. Komisioneri vëren se, konflikti i krijuar mes tij dhe dy shtetasve që posedojnë dy garazhet për të cilat ankuesi ka pretendime të cilat po i ndjek gjyqësisht dhe është ende në proces gjyqësor, merr zgjidhje pikërisht nga konkluzionet e këtij procesi gjyqësor, në përfundim të të cilit do të vendoset lidhur me pronësinë e garazheve.

Ankuesi ka pretenduar se gjobat e vëna nga Policia Bashkiake Tiranë janë të paligjshme e të padrejta pasi ai nuk ka parkuar në hapësirë publike por në truallin që është pronë private e tij, me dokumenta të rregullta ligjore, të cilat Policia nuk i ka marrë në konsideratë.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se është diskriminuar nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, lidhur me pretendimin se Policia Bashkiake nuk i është përgjigjur ankesës së tij, depozituar me datë 29.09.2023, Komisioneri vlerëson se, referuar këtij momenti, mosveprimi institucional ka të bëjë me moszbatimin e shkeljen e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, dhe kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se, lidhur me pretendimin e ankuesit, se institucioni sipërcituar, nuk i është përgjigjur kërkesës së tij; autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e pretendimit të ankuesit për moskthim përgjigje nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj².

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e subjektit ankues për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

Për sa më sipër, subjekti ankues mund t’i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së informimit

Së dyti, lidhur me pretendimin e ankuesit se Policia Bashkiake Tiranë e ka diskriminuar atë duke e gjobitur në mënyrë të paligjshme, Komisioneri vlerëson se, vlerësimi nëse gjobat janë vendosur në përputhje me ligjin dhe në zbatim të drejtë të tij, nuk është në kompetencën e Komisionerit.

² Për analogji citojmë Vendimin nr. 231, datë 25.11.2021 të KMD-së, Vendimin nr. 256, datë 29.12.2021, të KMD-së, Vendimin nr. 167, datë 22.08.2022, të KMD-së.

Ligji nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, rregullon misionin, organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Policisë Bashkiake në Republikën e Shqipërisë, marrëdhëniet e punës së punonjësit të Policisë Bashkiake, si dhe masat për ruajtjen e rendit e të sigurisë publike në komunitet.

Policia Bashkiake ka si mision ushtrimin e funksioneve në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarëvajtjes së punëve publike, miradministrimit të hapësirave publike dhe mbrojtjes së mjedisit në territorin e juridiksionit të saj.

Në fushën e rendit dhe sigurisë në komunitet, Policia Bashkiake:

- a) merr masa të sigurisë për zbatimin e planit të emergjencës së bashkisë për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, si dhe bashkëpunon me strukturat e mbrojtjes civile pranë bashkisë dhe prefektit të qarkut për kapërcimin e tyre;
- b) kontrollon zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor në territorin e juridiksionit të saj, sipas parashikimeve në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që lidhen me Policinë e Shtetit;
- c) vendos kufizimin e qarkullimit në rrugë jashtë qendrave të banuara për ditët e festave lokale në bashkëpunim me organet e Policisë Rrugore;
- ç) bashkëpunon me Policinë e Shtetit për mbikëqyrjen e sigurisë brenda territorit të juridiksionit të saj;
- d) bashkërendon masat me Policinë e Shtetit për ruajtjen e rendit e të qetësisë publike në raste të aktiviteteve në territorin e juridiksionit të bashkisë;
- dh) verifikon zbatimin e ligjshmërisë dhe patrullimin periodik në bashkëpunim me Policinë e Shtetit përgjatë vijës bregdetare publike dhe në zonat çlodhëse të ujërave të brendshme në thellësi të territorit, për sigurinë në det, plazhe dhe në ujërat e brendshme në thellësi të territorit të juridiksionit të bashkisë;
- e) monitoron respektimin e ndarjes së hapësirës së plazhit gjatë ushtrimit të veprimtarisë të çdo personi juridik apo fizik pranë stacioneve të plazhit në territorin e juridiksionit të bashkisë;
- ë) merr masa sigurie në veprimtaritë sportive dhe ndeshjet e futbollit gjatë organizimit dhe zhvillimit të tyre si personel sigurie;
- f) mbështet strukturat përgjegjëse të bashkisë për strehimin social, për procedurat e zhvendosjes së individëve ose familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre;
- g) merr masa për ruajtjen e objekteve në pronësi të bashkisë, si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj.

Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative janë të parashikuara në ligjet e veçanta dhe aktet e këshillit bashkiak.

Punonjësi i Policisë Bashkiake për shkeljet e konstatuara merr masa administrative bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore që parashikojnë kundërvajtje administrative.

Kur punonjësi i Policisë Bashkiake krijon dyshimin e arsyeshëm se një veprim ose mosveprim i një personi fizik ose juridik përbën një kundërvajtje administrative, konstatimi i së cilës nuk është në kompetencën e saj dhe se nga ai veprim mund të shkaktohet një dëm i pariparueshëm dhe me pasoja të rënda ndaj interesit publik apo palëve të treta, për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo për mjedisin, punonjësi i strukturës konstatuese ka të

drejtë të marrë masa për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërvajtësit dhe të njoftojë organin përkatës për shkeljen e konstatuar.

Procedura për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative nga Policia Bashkiake kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, në nenin 1, të tij, ka përcaktuar se:

“Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, përcaktimi i procedurave dhe i afateve të ankimit ndaj akteve të organeve të administratës publike, që vendosin dënime administrative, si dhe i procedurave të ekzekutimit të sanksioneve administrative.”

Ky ligj zbatohet për të gjitha vendimet e organeve të administratës publike, që parashikojnë dënime administrative e që krijojnë pasoja juridike në raste individuale. Vendimi i administratës publike, që parashikon dënim administrativ, këtu dhe në vijim do të quhet vendim për kundërvajtjen administrative. (Neni 2 Fusha e zbatimit të ligjit)

Mënyrat e marrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, përcaktohen si më poshtë vijon:

1. Për kundërvajtjen administrative parashikohet:

a) marrja e gjobës në vend, në rastet kur kjo parashikohet nga ligji i veçantë;

b) mbajtja e aktit administrativ që konstaton shkeljen apo e një dokumenti tjetër të barasvlershëm me të nga personat e ngarkuar me ligj ose me akte të organeve të pushtetit vendor, në rastet kur konstatimi i shkeljes është i lidhur me vendin ku ndodh ngjarja;

c) nxjerrja dhe njoftimi i vendimit të organit të ngarkuar nga ligji, kur konstatimi i ngjarjes lidhet me shqyrtimin e dokumentacionit apo të të dhënave të tjera.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjën "b" të pikës 1 të këtij neni, akti administrativ që konstaton shkeljen apo dokumenti tjetër i parashikuar nga ligji i posaçëm si i barasvlershëm me të e që nuk është procesverbal gjobe, i bashkëlidhet vendimit për kundërvajtjen administrative, që vendos dënimin me gjobë.

3. Në rastet kur dënimi me gjobë është pjesë e një akti administrativ më të gjerë, që trajton edhe çështje të tjera, pjesa që përcakton dënimin me gjobë trajtohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, sipas organit që e ka nxjerrë atë. (Neni 13)

Neni 15, ka parashikuar se: *“Mungesa e respektimit të ankimit në rrugë administrative, ka përcaktuar se, vendimi për kundërvajtjen administrative nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore nëse ligji i posaçëm parashikon të drejtën e subjektit për t'u ankuar në rrugë administrative, por kjo e drejtë nuk është ushtruar. Për ekzekutimin e tij zbatohen dispozitat e kreut V të këtij ligji. “*

Neni 17, “Afatet e shqyrtimit”, përcakton se:

“Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj pas kryerjes së kësaj kundërvajtjeje.

Nga rregulli i parashikuar në pikën 1 të këtij neni përjashtohen ato raste, për të cilat:

a) kompetente për shqyrtimin e kundërvajtjes është gjykata;

- b) ligji i veçantë ka parashikuar afate të ndryshme;
- c) konstatimi i shkeljeve bëhet nga struktura auditimi apo inspektimi. Gjatë kryerjes së auditimeve apo inspektimeve, afatet dhe procedurat rregullohen nga ligji i posaçëm.”

Objekti i këtij kreu janë vendimet për kundërvajtjet administrative, që parashikojnë dënime me gjobë, të vendosura nga:

- a) institucionet e organizuara si inspektorate shtetërore, pavarësisht nga mënyra e organizimit të tyre dhe nga objekti i veprimtarisë;
- b) organet e administratës publike, që kanë kompetencën të nxjerrin akte administrative individuale, veprimtaria e të cilave rregullohet me ligj të posaçëm, i cili është referuar në trajtimin e procedurave në kreun III, të këtij ligji;
- c) organet e administratës publike, që kanë kompetencën të nxjerrin akte administrative individuale, veprimtaria e të cilave rregullohet me ligj të posaçëm, ligj i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative dhe dënimin me gjobë, por nuk është referuar në trajtimin e procedurave në kreun III të këtij ligji;
- ç) autoritetet e kontrollit dhe të mbikëqyrjes publike, të cilat, në përputhje me kompetencat e tyre, sipas përcaktimit në ligj, kanë të drejtën e vendosjes së masave administrative me gjobë dhe që në strukturat e tyre nuk kanë persona të ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve administrative;
- d) organet e administratës publike, nëse ligji i posaçëm, i miratuar pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, parashikon kundërvajtje administrative dhe dënim me gjobë dhe referon në përgjithësi në këtë ligj;
- dh) bashkitë dhe komunat. (neni 20)

Në nenin 26, të këtij ligji, është parashikuar ankimi në rrugë gjyqësore, duke specifikuar si më poshtë:

“1. Kundër vendimit për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënim me gjobë, të nxjerrë nga organi i administratës, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. 2. Në rastin e shqyrtimit në rrugë gjyqësore të vendimit për kundërvajtjen administrative, që ka parashikuar dënim me gjobë, gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit dhe, kur gjykon se organi administrativ ka keqinterpretuar ligjin, ka tejkualuar apo ka shpërdoruar kompetencat, vendos edhe në lidhje me dënimin. 3. Barra e provës në kundërvajtjen administrative bie mbi organin e administratës publike që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative.”

Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, afatet dhe mënyra e ankimit të kundërvajtjeve administrative/gjobave në rastin konkret, është e parashikuar dhe e rregulluar ligjërisht.

Për rrjedhojë, subjekti ankues ka shteruar ankimin administrativ, duke i ankimuar gjobat/kundërvajtjet administrative, pranë organit që i ka i vendosur ato, dhe vlerësimi i tyre duhet bërë nga organet përgjegjëse dhe të caktuara me ligj, pranë organit që ka nxjerrë aktin, dhe gjykatës.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e pretendimit të ankuesit për paligjshmërinë e gjobave të vendosura në dëm të tij nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë, nuk

bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj³.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b⁴”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e subjektit ankues për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

Për sa më sipër, subjekti ankues, pas ankimimit pranë organit përgjegjës për kundërshtimin e gjobave të vëna nga Policia Bashkiake Tiranë, lidhur me parkimin e automjeteve të tij, mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për kundërshtimin e gjobave të vëna nga Policia Bashkiake Tiranë, lidhur me parkimin e automjeteve të tij.

Së treti, subjekti ankues ka cilësuar që është diskriminuar nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë, për shkak të “vendbanimit” të tij dhe “çdo shkak tjetër”.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivist të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë⁵.”

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

³ Për analogji citojmë Vendimin nr. 231, datë 25.11.2021 të KMD-së, Vendimin nr. 256, datë 29.12.2021, të KMD-së, Vendimin nr. 167, datë 22.08.2022, të KMD-së.

⁴ Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”*

⁵ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përrjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përrjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohej vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

- *Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të vendbanimit.*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, ndodhemi përpara rastit, kur ankuesi ka pretenduar për paligjshmëri të veprimeve të Policisë Bashkiake Tiranë, pretendim i cili është objekt i shqyrtimit gjyqësor, ardhur për shkak të vendbanimit të tij. Lidhur me këtë fakt, Komisioneri vëren se si ankuesi, ashtu edhe dy banorët (shtetasit K. K dhe A. P) krahasuar me të cilët ai ka pretenduar se është disfavored nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë, janë banorë të të njëjtës lagje, pasi banesat e tyre/pallatet ku jetojnë janë afër (apo ngjitur) njëri-tjetrit. Pra, vendbanimi nuk ka shërbyer si shkak në vetvete për disfavoredimin e tij krahasuar me K. K dhe A. P.

- *Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim “për çdo shkak tjetër”.*

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁶. Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁷.

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi.”

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive.*”

Referuar përmbajtjes së nenit 1 të LMD-së, rezulton tepër e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e përmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetvehte është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, subjekti ankues nuk ka identifikuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat personale të përcaktuara në LMD.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën

⁶ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁷ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë shkakut specifik, duke mos arritur të identifikoj se cili është ky shkak.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Pala ankuese nuk parashtroi fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucioneve përgjegjëse që të jenë motivuar nga shkaqet e pretenduara.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Së fundmi, lidhur me pretendimin e ankuesit se punonjësit e Policisë Bashkiake Tiranë, kanë shpërdoruar detyrën përmes ndikimit nëpërmjet korrupsionit apo favorizimit të padrejtë të shtetasve (K. K dhe A. P) me të cilët ai është në konflikt, Komisioneri vëren se, hetimi i tyre nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së.

Pra, për sa më sipër është organi i Prokurorisë, organi kompetent që ushtron ndjekjen penale.⁸

Neni 1, dhe 1/b, i Kodit Penal, përcakton se: “*Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundravajtje penale. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre*”.

Neni 248⁹, i po këtij Kodi, përcakton se: “*Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të*

⁸ Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë shpreh se: “*Prokuroria ushtron ndjekjen penale....*”

⁹ Shpërdorim i detyrës.

shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.”

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht: *“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.*

Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore.

Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.”

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues K. Ç, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA